

CERP

KONKURRUESHMËRIA DHE
GATISHMËRIA PËR EKSPORTIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

RAPORT

Hulumtim: Inspektimet e Bizneseve në Kosovë



Prishtinë, Kosovë
Tetor, 2023



OPERATORI EKONOMIK:



D&D BUSINESS SUPPORT CENTER

Rr. "Xheladin Hana", Iliria Building,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564
E-mail: info@dd-bsc.com
Web: www.dd-bsc.com

AUTORITETI KONTRAKTUES:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

MINISTRIA E INDUSTRIJË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Lagjja e Spitalit, rr. "Arbënor e AstritDehari",
nr. 21, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.
Tel: +383 (0) 200 36 512
Email: zkp.mti@rks-gov.net
Web: www.mint.rks-gov.net

Ky studim është financuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, pikëpamjet e shprehura në këtë raport i përkasin autorëve të D&D Business Support Center dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Raporti është hartuar duke u bazuar në të dhënat nga sondazhi me ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e Prodhimit, Shërbimit dhe Tregtisë.

LISTA E SHKURTESAVE

MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
D&D	D&D Business Support Center
CERP	Projekti për Konkurrueshmërinë dhe Gatishmërinë e Eksportit
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. HYRJE.....	6
3. METODOLOGJIA.....	7
4. KORNIZA E MOSTRËS.....	8
5. ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE.....	9
5.1. Eksporti.....	10
5.2. Përqindja e eksportit	11
6. INSPEKTIMET.....	11
6.1. Agjensionet që inspektuan bizneset.....	11
6.2. Agjencit dhe inspektimet	12
6.3. Kohëzgjatja para gjatë dhe pas inspektimit	13
6.4. Kostot.....	13
6.5. Gjobat.....	14
6.6. Vizitat nga inspektoriatet.....	15
6.7. Arsyjet e gjobave.....	15
6.8. Njohuritë e inspektoriateve.....	16
6.9. Problematikat kryesore gjatë procesit të inspektimit	16
6.10. Ndryshimet negative dhe pozitive.....	16
7. KONKULZIONE DHE REKOMANDIME	17
8. ANNEX 1. PYETESORI.....	18

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Struktura e ndërrmarjeve sipas madhësisë.....	8
Figura 2. Struktura e ndërrmarjeve sipas aktiviteteve	9
Figura 3. Sektori në të cilin operon firma.....	10
Figura 4. Eksporti.....	10
Figura 5. Inspektimet.....	11
Figura 6. Agjensionet që inspektuan bizneset.....	12
Figura 7. Numri i vizitave inspektuese të kryera.....	12
Figura 8. Kohëzgjatja gjatë inspektimit.....	13
Figura 9. Kostot e inspektimeve.....	14
Figura 10. Vlera e gjobave	14
Figura 11. Vizitat nga inspektoriatet.....	15
Figura 12. Arsyjet e gjobave	15
Figura 13. Njohuritë e punonjësëve.....	16
Figura 14. Ndryshimet pozitive dhe negative.....	16

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Inspektimi i ndërmarrjeve ashtu si në çdo vend tjetër dhe në Kosovë paraqet një element kyç për zhvillimin e ambienteve të përshtatshme të biznesit dhe sigurimin e ndërtimit të një shoqërie të drejtë dhe të rregullt. Ky proces është i rëndësishëm për të garantuar respektimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë, si dhe për të zvogëluar rreziqet potenciale për shkelje të rregullave.

Një inspektim efikas dhe i drejtë është thelbësor për të rritur besimin e investitorëve dhe konsumatorëve dhe për të kontribuar në rritjen e përgjegjshmërisë së biznesit. Kështu, kjo përmirëson klimën e përgjithshme të biznesit dhe kontribuon në arritjen e qëllimeve të zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Rrjedhimisht duke pas parasysh rëndësinë e inspektimit, nevoja për hulumtimin e gjendjes reale dhe përmirësimit të saj mbetet e pashmangshme. Andaj, CERP/MINT ka kontraktuar D&D BSC për të zhvilluar hulumtimin i cili nxjerr në pah përvojat e ndërmarrjeve me procesin e inspektimit si dhe sfidat dhe vështirësitë të cilat këto ndërmarrje hasin përgjatë këtij procesi duke u bazuar në dy indikatorët e paracaktuara nga projekti:

- ✚ Reduktimi i kostos vjetore të pajtueshmërisë së inspektimit për ndërmarrjet; dhe
- ✚ Numrin e vizitave të inspektimit që kompanitë përballojnë çdo vit.

Të gjeturat e këtij hulumtimi janë bazuar në 600 intervistat e realizuara me NVM të cilat përbëjnë një mostër gjithpërfshirëse të sektorëve të prodhimit, shërbimit, dhe tregtisë në Kosovë.

Nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anketuara përmes këtij hulumtimi, për nga madhësia 74% i përkasin kategorisë mikro, 19% janë ndërmarrje të vogla ndërsa pjesa e mbetur 7% janë ndërmarrje të kategorisë së mesme.

Sa i përket aktivitetit të biznesit, 51% e këtyre ndërmarrjeve janë në sektor të prodhimit, 36% e tyre aktivitet kryesor të biznesit kanë tregtinë si dhe pjesa tjetër ose 14% kanë aktivitet kryesor ofrimin e shërbimeve të ndryshme.

Ndërsa sa i përket procesit të inspektimit, sipas të gjeturave të këtij hulumtimi për periudhën Janar – Gusht 2023, 85% e ndërmarrjeve kanë qënë pjesë e procesit të inspektimit ndërsa pjesa tjetër prej 15% kanë pohuar se përgjatë këtij viti nuk janë inspektuar ende nga ndonjë institucion në Kosovë.

Përmes këtij hulumtimi janë nxjerr në pah eksperiencat e ndërmarrjeve në proces të inspektimit dhe sfidat dhe vështirësitë të cilat janë si në vijim:

- ✚ Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit midis ndërmarrjes dhe inspektorëve;
- ✚ Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i performancës;
- ✚ Përmirësimi i infrastrukturës së teknologjisë informative dhe mënyrave të thjeshta dhe efikase për raportimin dhe monitorimin e inspektimeve.

2. HYRJE

Në një kohë kur rendi dhe efikasiteti në sektorin publik dhe privat janë sfidat themelore të shërbimeve qeveritare, sistemi i inspektimit luan një rol kritik në sigurimin e respektimit të rregullave dhe standardave të ndryshme. Ky projekt është një përpjekje e rëndësishme për të kuptuar, vlerësuar, dhe përmirësuar sistemin aktual të inspektimit në Kosovë.

Kjo iniciativë është thelbësore për disa arsye kryesore - Së pari, inspektimi efektiv është thelbësor për sigurinë publike dhe sundimin e ligjit. Ndërhyrja e duhur dhe efikase e autoriteteve inspektuese ndihmon në sigurimin e sigurisë së qytetarëve dhe ruajtjen e standardeve të larta të sigurisë ushqimore, mjedisore dhe të shëndetit publik. Së dyti - në një kontekst të zhvillimit ekonomik dhe investimeve të huaja, një sistem i denjë i inspektimit është thelbësor për të siguruar të drejtën dhe rregullin në treg.

Me qëllim të arritjes së dy indikatorëve të këtij projekti të cilët kanë të bëjnë me 1) Reduktimin e kostos vjetore të inspektimit për ndërmarrjet dhe 2) Numrin e vizitave të inspektimit që kompanitë përballen çdo vit, është përpiluar një pyetësor i cili i është adresuar gjithsej 600 ndërmarrjeve aktive në Republikën e Kosovës, përmes të cilit janë identifikuar problematikat në sistemin e inspektimit dhe ka shërbyer si burim kryesor i informacionit për analizën dhe rekomandimet tona për riformimin e sistemit.

Në pjesën e mëposhtme të këtij raporti, janë shqyrtuar rezultatet e pyetësorit dhe është bërë analiza e të dhënave statistikore dhe gjetjet kyçe të cilat kanë ndihmuar në nxjerrjen e përfundimeve dhe paraqitjen e rekomandimeve specifike për përmirësim të sistemit të inspektimit

3. METODOLOGJIA

Ky hulumtim është financuar nga CERP/MINT dhe zbatuar nga D&D BSC për të pasur më të qartë këndvështrimin e ndërmarrjeve aktive në Kosovë lidhur me procesin e inspektimit të tyre me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të këtij procesi duke adresuar lidhjet të cilat mungojnë. I njëjti do të shërbej në zvogëlimin e barrës administrative për biznese duke përmirësuar efikasitetin e shërbimeve të inspektimit dhe do të ndikoj në përmirësimin e kapaciteteve të firmave në fushën e eksportit, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tyre.

Duke pas synim arritjen e këtij qëllimi, fillimisht është përpiluar pyetëtori i cili është ndarë në dy pjesë:

- **PJESA E PARË** – Kjo pjesë e pyetëtorit kishte për qëllim të grumbullojë informacione themelore mbi kompanitë dhe karakteristikat e tyre. Pyetjet përfshijnë emrin e ndërmarrjes, vendndodhjen, pozitën e personit të intervistuar në ndërmarrje, gjininë e pronarit, sektorin operativ, numrin e punonjësve, statusin ligjor të ndërmarrjes, madhësinë dhe veprimtarinë e saj, si dhe informacionin në lidhje me eksportin e produkteve ose shërbimeve të ndërmarrjes. Ky informacion ishte thelbësor për të kuptuar kontekstin dhe karakteristikat e ndërmarrjeve që janë përfshirë në hulumtim dhe përvojën e tyre me shërbimet e inspektimit.

- **PJESA E DYTË** – Kjo pjesë e pyetëtorit ka përmbajtur pyetje që kishin për qëllim të zbulojnë dhe dokumentojnë përvojën e bizneseve me inspektimet përgjatë vitit 2023. Pyetjet përfshijnë aspekte të tilla si frekuenca e inspektimeve, shpenzimet e stafit për inspektimet, pagat bruto mujore të punonjësve të përfshirë në inspektime, gjobat e paguara nga biznesi, kënaqësia me punën e inspektorëve, dhe ndryshimet në procesin e inspektimit. Këto informacione kanë shërbyer për të kuptuar më mirë përvojën dhe sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset në lidhje me inspektimet dhe për të hartuar rekomandime në përputhje me të dhënat e grumbulluara.

Të dhënat primare të mbledhura në këtë hulumtim janë bërë përmes vizitave fizike dhe komunikimit online me pronarët e ndërmarrjeve apo njërin nga drejtuesit e lartë, të cilët kanë pasur përvojë të mjaftueshme në aktivitetet e përgjithshme të biznesit.

4. KORNIZA E MOSTRËS

Në kuadër të këtij hulumtimi janë shfrytëzuar të dhënat primare, të realizuara nga kompania konsulente D&D Business Support Center dhe të financuara nga MINT. Përzgjedhja e mostrës është bërë duke përfshirë ndërmarrje nga të gjitha regjionet e Kosovës. Kjo mostër i është përshtatur llojit të veprimtarisë së ndërmarrjeve të intervistuar në mënyrë që të jetë gjithëpërfshirëse dhe të pasqyrojë gjendjen reale të sektorit, mënyrën e operimit të punës së tyre dhe procesin e inspektimit të cilit i nënshtrohen.

Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi për periudhën Janar – Gusht 2023, nga 600 bizneset e intervistuar 85% prej tyre kanë qënë pjesë e procesit të inspektimit ndërsa pjesa tjetër prej 15% kanë deklaruar se përgjatë këtij viti nuk janë inspektuar ende nga ndonjë institucion në Kosovë.

Anketimi ka përfshirë 7 regjionet e Kosovës:

Prishtinë - 239 ndërmarrje

Mitrovicë - 58 ndërmarrje

Pejë - 62 ndërmarrje

Prizren - 66 ndërmarrje

Gjilan - 61 ndërmarrje

Gjakovë - 48 ndërmarrje



Në komunën e Prishtinës janë intervistuar 239 prej 600 bizneseve, që përfaqësojnë 40% të totalit. Në Mitrovicë janë intervistuar 58 biznese, që përbëjnë 10% të totalit. Në Pejë janë intervistuar 62 biznese, që përfaqësojnë gjithashtu 10%. Në Prizren janë 66 biznese, që përbëjnë 11% të totalit. Gjilani ka 61 biznese, që përfaqësojnë 10%, ndërsa Gjakova ka 48 biznese, ose 8% të totalit

Pjesë e kësaj mostre të shfrytëzuar për nxjerrjen e të dhënave primare dhe analizimin e tyre të mëtutjeshëm janë konsideruar intervistat me 600 ndërmarrje si numër i përgjithshëm, nga të cilat 74% i përkasin kategorisë mikro, 19% janë ndërmarrje të vogla, ndërsa pjesa e mbetur 7% janë ndërmarrje të kategorisë së mesme.




Figura 1. Struktura e ndërmarrje sipas madhësisë

Sa i përket aktivitetit të biznesit, 303 apo 51% e këtyre ndërmarrjeve janë në sektor të prodhimit, 216 apo 36% e tyre aktivitet kryesor te biznesit kanë tregtinë si dhe pjesa tjetër 81 apo 14% kanë aktivitet kryesor ofrimin e shërbimeve të ndryshme.




Figura 2. Struktura e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve

5. ANALIZA E TË DHËNAVE PRIMARE

Sipas të gjeturave të këtij hulumtimi, nga numri i përgjithshëm i intervistave të realizuara, prej tyre 391 të intervistuar apo 65% janë pronar dhe menaxher të ndërmarrjes njëkohësisht, 67 prej tyre apo 11% janë pronarë të ndërmarrjes, 122 apo 20% janë me pozitë menaxher 14 apo 2% ishin kontabilist të ndërmarrjes ndërsa pjesa tjetër prej 6 apo 1% janë avokat ligjor të këtyre ndërmarrjeve.

Përmes pyetësorit, përkundër të intervistuarit ne rastet kur nuk është intervistuar pronari, të njëjtit janë pyetur dhe për gjininë e pronarit të ndërmarrjes në mënyrë që të kemi një pasqyrë mbi pronësinë e ndërmarrjes, nga ku është kuptuar se 488 apo 81% ndërmarrje të intervistuar kanë pronar të gjinisë mashkullore ndërsa 112 apo 19% ndërmarrje nga totali kanë pronar me gjini femrore.

Ngjashëm, nëpërmjet këtij pyetësori kemi kuptuar dhe sektorin në të cilin këto biznese operojnë, nga ku është kuptuar se pjesa më e madhe nga numri i përgjithshëm i të intervistuarëve operojnë në sektorin e prodhimit me 50.50% e ndjekur nga tregtia me shumicë dhe pakicë me 30.33%.

Për detaje më të hollësishme lidhur me sektorin e operimit të ndërmarrjeve të cilat janë intervistuar shihni grafën në vijim:




Figura 3. Sektori në të cilin operon firma

Tutje, ndërmarrjet janë pyetur dhe për numrin e të punësuarve në kompaninë e tyre dhe gjininë dominuese në ndërmarrje, nga ku është kuptuar se në 600 ndërmarrje janë të punësuar gjithsej 6,958 punëtorë, me 61% meshkuj dhe 39% femra. Në mesataren për secilën kompani, 7.13% janë meshkuj dhe 4.47% janë femra.

Ndërsa sa i përket statusit ligjor të këtyre ndërmarrjeve, nga numri i përgjithshëm i tyre 422 ndërmarrje apo 70.33% janë të regjistruara si Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, 169 apo 28% janë të regjistruara si biznese individuale, 6 apo 1% janë të regjistruara si shoqëri aksionare dhe pjesa tjetër prej 3 apo 0.50% janë regjistruar si ortakëri e përgjithshme.

5.1. Eksporti

Nga 600 bizneset e intervistuar, 53 biznese apo 9% eksportojnë mallrat e tyre, ndërsa 547 biznese apo 91% nuk eksportojnë.

Ky informacion ndihmon të kuptojmë se sa biznese janë të përfshira në tregtinë ndërkombëtare, të rëndësishme për strategjitë e biznesit dhe analizën e tregut.




Figura 4. Eksporti

5.2. Përqindja e eksportit

Rezultatet tregojnë se 53 nga 600 bizneset e inspektuara janë pjesë e tregtisë ndërkombëtare dhe eksportojnë një përqindje të konsiderueshme të produkteve ose shërbimeve të tyre që është 2,250% në total ose mesatarisht 42.45%.

6. Inspektimet

Sipas të dhënave të pranuar nga 600 ndërmarrje rreth inspektimit të tyre, 508 apo 85% prej tyre deklaruan që ishin inspektuar gjatë vitit 2023, ndërsa 92 apo 15% tjerë treguan që nuk kanë pasur ende inspektim gjatë këtij viti.




Figura 5. Inspektimet

6.1. Agjensionet që inspektuan bizneset

Sipas të dhënave nga intervistimi i bizneseve, ndarja e inspektoriateve bazuar në numrat e inspektimeve është si vijon:

- Inspektorati i Punës ka kryer 301 inspektime, përbërë pothuajse gjysmën e tyre, me një përqindje prej 49%.
- Inspektorati i Tregut ka kryer 143 inspektime, përkatësisht 23% të totalit.
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka kryer 130 inspektime, që përfaqësojnë 21% të inspektimeve totale.

Inspektoriatet e tjera kanë numer më të ulët të inspektimeve, të cilat mund të shihen në grafikun e mëposhtëm.




Figura 6. Agjencionet që inspektojnë bizneset

6.2. Agjencitë dhe inspektimet

Në vitin 2023, në 508 biznese të ndryshme të anketuara në Kosovë në total janë kryer 1,195 inspektime. Sipas të dhënave nga anketa, inspektimet më të shpeshta janë kryer kryesisht nga Inspektorati i Punës i cili ka kryer 541 vizita inspektuese në terren, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me 333 vizita dhe Inspektorati i Tregut me 252 vizita respektivisht.




Figura 7. Numri i vizitave inspektuese të kryera

6.3. Kohëzgjatja para, gjatë, dhe pas inspektimit

Sipas të dhënave, stafi i bizneseve të intervistuar ka përdorur në total 5,180 minuta për përgatitjen e inspeksioneve nga të gjitha agjencitë gjatë vitit 2023. Kjo reflekton se procesi i përgatitjes për inspektimet ka kërkuar një angazhim të konsiderueshëm të burimeve njerëzore. Është thelbësore që ky angazhim të menaxhohet me efikasitet për të zvogëluar kostot dhe kohën e nevojshme për inspektimet e ardhshme.

Duke u bazuar në grafën e mëposhtëm, tek pyetja se sa minuta pune kanë shpenzuar të gjithë punonjësit e kompanive gjatë inspektimit të agjensive të inspektimit, mund të themi se inspektoriati i cili rezultoi me më së shumti minuta për të kryer inspektime ishte Inspektoriati i Punës me 16,945 minuta nga totali i 508 bizneseve të inspektuara nga ky inspektoriat, kurse i renditur i dyti rezultoj Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë me 11,765 minuta. Në total, Informatat rreth inspektoriateve të tjera mund të shihen në grafën e mëposhtëm të paraqitura në minuta.




Figura 8. Kohëzgjatja gjatë inspektimit

Në lidhje me kohën që punonjësit e biznesit harxhojnë për të zbatuar procedurat pas inspektimit, evidentohet se ata që janë subjekt i inspektimeve nga Inspektoriati i Punës kanë kërkuar më shumë kohë për të zbatuar këto procedura, me një total prej 3,415 minutash. Gjithashtu, për të gjithë punonjësit e këtyre bizneseve, koha e përgjithshme e angazhimit për të implementuar procedurat pas inspektimit është 7,456 minuta. Ky informacion ofron një pamje të detajuar rreth kohës që nevojitet për zbatimin e këtyre procedurave nga punonjësit e bizneseve të inspektuara.

6.4.Kostot

Në bazë të rezultateve të intervistave, inspektoriatet me fokus kryesor për inspektimin e bizneseve janë Inspektoriati i Tregut, Inspektoriati i Punës dhe Agjencia e ushqimit dhe veterinarisë.

Nga kjo mund të themi se vleresimi i kostove të kohës së punës së shpenzuar në inspektime lidhet me këto inspektoriate. Pronarët e bizneseve gjatë intervistimit deklaruan se paguajnë punëtorët të cilët përfshihen në këto inspektime.

Paga Bruto mesatare e këtyre punëtorëve të cilët janë përfshirë në inspektime është rreth 347.78 euro.

Në grafën e mëposhtëm kemi të bëjmë me kosotat e bizneseve duke përfshirë kostot e udhëtimit, nëse udhëtoni në inspektorata, shumën e paguar jashtë formalitetit, si dhe kostot e tjera për inspektimet që janë bërë. Disa biznese kanë paguar shuma të konsiderueshme për dokumente administrative, kopjimin, testimin, dergimin e dokumenteve dhe kostot e transportit, ndërsa të tjerët kanë paguar shuma më të ulta ose aspak.

Nga rezultati i anketës dalim në përfundim se totali i kostove të bizneseve të inspektuara është 7,286.00 euro për periudhën Janar/Gusht 2023.




Figura 9. Kostot e inspektimeve

6.5. Gjobat

Sa i përket gjobave të cilat janë paguar nga bizneset gjatë vitit 2023 grafi i mëposhtëm jep një pasqyrë të gjobave të përgjithshme, të ndara sipas inspektoriateve të ndryshme.

Gjithsej, vlera totale e gjobave të paguara nga bizneset është 52,005.00 euro.




Figura 10. Vlera e gjobave

6.6. Vizitat nga inspektoriatet

Në pyetjen se a janë të kënaqur bizneset me punën e inspektoriateve gjatë vizites inspektuse, bazuar në të dhënat e pranuar, mund të shohim se Inspektoriati i Punës kishte pasur më së shumti vizita në biznese por edhe që ishte vlerësuar më së shumti për sjelljet pozitive të tyre.




Figura 11. Vizitat nga inspektoriatet

Në përgjithësi, vlerësimet tregojnë se ekziston një nivel i konsiderueshëm në lidhje me njoftimin paraprak për vizitën e inspektimit dhe është një numër shumë i vogël i bizneseve të cilët kanë qënë të njoftuar për vizitat e inspektoriateve.

6.7. Arsyjet e gjobave

Duke u bazuar në pyetjen se sa përqind e gjobave ishin për arsyjet e poshtëpërmendura, nga totali i bizneseve të inspektuara të cilat janë gjobitur, në grafikun e mëposhtem mund të shihen, se sipas tyre 57% e gjobave janë dhënë për shkak të mungesës së përputhshmërisë, ndërsa vetëm 19% e gjobave janë për shkak të vendimeve të padrejta nga inspektorët.




Figura 12. Arsyjet e gjobave

6.8. Njohuritë e inspektoriateve

Bazuar në të dhënat e pranuar, shumica e bizneseve shprehin bindjen se inspektorët kanë njohuri të mjaftueshme rreth aspekteve teknike dhe shkencore që janë të domosdoshme për të kryer inspektimet me efikasitet. Megjithatë, ka disa vlerësime të kundërta të cilat tregojnë se ka raste kur bizneset kanë dyshime lidhur me njohuritë e inspektorëve në këtë fushë.

Në lidhje me dijen e punonjësve rreth procedurave të inspektimit dhe detyrimeve teknike dhe ligjore, 491 ose 97% nga kompanitë e anketuara kanë përcaktuar se punonjësit e tyre kanë njohuri rreth këtyre procedurave.




Figura 13. Njohuritë e punonjësëve

6.9. Problematikat kryesore gjatë procesit të inspektimit

Me qëllim të evidentimit të problematikave që bizneset hasin, dhe rrjedhimisht adresimin e tyre, pyetesori ka përbajtur një pyetje e cila tenton të identifikoj problemet kryesore që pronarët e bizneseve hasin përgjatë procesit të inspektimit

Kërkesat e pakjarta teknike dhe ligjore përbëjnë problematikën kryesore, duke shprehur 32.69% të rasteve të identifikuara. Sjellja e pahijshme e inspektorëve është problemi më i rrallë, duke paraqitur vetëm 0.38% të rasteve të inspektimit.

6.10. Ndryshimet negative dhe pozitive

Sa i përket ndryshimeve pozitive dhe negative të punës së inspektoriatevë ndër vite, nga të dhënat e pranuar nga bizneset e inspektuara, rezulton që:

- 186 ose 37% nga bizneset e inspektuara raportuan se kishin vënë re ndryshime pozitive.
- 8 ose 2% prej tyre konfirmuan se kishin vënë re ndryshime negative.
- Ndërsa shumica, 314 ose 62% biznese, thanë se nuk kishin vënë re ndonjë ndryshim.




Figura 14. Ndryshimet pozitive dhe negative

7. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Projekti “Riformimi i sistemit të inspektimit të ndërmarrjeve - sistemi i shkëmbimit të të dhënave të ndërveprimit” nxjerr në pah përparsitë dhe sfidat që bizneset i hasin përgjatë inspektimit të ndërmarrjeve dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e ambienteve të përshtatshme të bizneseve në Kosovë.

Ky proces është një mjet kryesor për garantimin e respektimit të standardeve të sigurisë dhe cilësisë, dhe njëkohësisht ndihmon në zvogëlimin e rreziqeve të shkeljeve të rregullave. Inspektimi efikas dhe i drejtë ndihmon në rritjen e besimit të investitorëve dhe konsumatorëve dhe kontribuon në përgjegjshmërinë e biznesit.

Duke pas parasysh qëllimin kryesor të këtij projekti, është zhvilluar dhe hulumtimi përmes pyetësorit i cili i është adresuar 600 ndërmarrjeve aktive në Kosovë. I njejtë ka ndihmuar që të kemi një pasqyrë më të qartë lidhur me procesin aktual të inspektimit, sfidat dhe vështirësitë që hasin këto ndërmarrje përgjatë këtij procesi.

Rrjedhimisht, në kuadër të të gjeturave të këtij hulumtimi është kuptuar se ndërmarrjet shprehin pakënaqësi lidhur me kërkesat e inspektorëve të cilat shpeshherë janë të paqarta për ndërmarrjet, andaj përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjes dhe inspektorëve, duke siguruar që informacioni dhe rregulloret të jenë më të qarta për të dyja palët do të ishte thelbësor në efektivitetin e inspektimit ndaj bizneseve.

Ndonëse një përqindje relativisht të ulët e gjobave shpërndahen për shkak të vendimeve të padrejta nga inspektorët, monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i performancës është thelbësor.

Reformat në sistemin e inspektimit duhet të shoqërohen me përmirësimin e infrastrukturës së teknologjisë informative dhe mënyrave të thjeshta dhe efikase për raportimin dhe monitorimin e inspektimeve. Ky hulumtim dhe projektet e tjera të ngjashme duhet të vazhdojnë të jenë pjesë e një përpjekje të përbashkët për të forcuar sektorin e eksportit në Kosovë dhe për të ndihmuar bizneset të përmirësojnë konkurrencën e tyre në tregjet ndërkombëtare.

8. ANNEX 1. PYETESORI

Përshëndetje, unë jam _____ dhe punoj në _____ . _____ u kontraktua nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në kuadër të projektit CERP të financuar nga Banka Botërore, të bëjë një anketë me bizneset në Kosovë për të kuptuar më qartë përvojat e bizneseve me shërbimet e inspektimit.

Qëllimi i projektit CERP është të mbështesë certifikimin e produkteve për tregjet e eksportit, të forcojë kapacitetet e bizneseve të orientuara nga eksporti dhe të përmirësojë konkurrencën e tyre. Projekti është ristrukturuar për t'iu përgjigjur nevojave në ndryshim të MSME-ve si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19.

Projekti CERP përbëhet nga dy komponentë:

- Nënkomponenti 1.1: Mbështetja e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për të përmirësuar konkurrencën dhe gatishmërinë për eksport (10.4 milion €) përmes Programit të Granteve të Përputhshme (MGP).
- Nënkomponenti 1.2: Reformimi i sistemit të inspektimit të biznesit

Reforma e sistemit të inspektimit synon të ulë barrën administrative për bizneset, duke rritur në këtë mënyrë efikasitetin e shërbimeve të inspektimit, duke ofruar:

- Sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave, E-inspektorati;
- Sistemi i shkëmbimit të të dhënave, ndërveprueshmëria dhe ndërveprimi i sistemit të TIK
- Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve profesionale të inspektorëve.

Përgjigjet tuaja janë plotësisht konfidenciale dhe anketa do të zbatohet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kërkimit. Do të ishim mirënjohës për pjesëmarrjen tuaj në këtë anketë dhe do t'ju inkurajonim të bashkëpunoni. Jeni të interesuar të merrni pjesë në këtë pyetësor?

Data e intervistës:

Emri i anketuesit: _____

ID: _____

Informacioni i Sfondit

1. Emri i kompanisë _____
2. Vendndodhja e biznesit (p.sh. qyteti): _____
3. Çfarë pozicioni mbani aktualisht në kompani? *Nëse tjetër, mos e plotësoni intervistën me këtë biznes.*
 - a. Pronar dhe menaxher
 - b. Pronar por jo menaxher
 - c. Menaxheri
 - d. Përfaqësues Ligjor/Avokat i shoqërisë
 - e. Menaxher Financiar/Kontabilist

4. Çfarë gjinie është pronari i kompanisë?
 - a. Mashkull
 - b. Femër

5. Në cilin sektor operon firma juaj?
 - a. Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi
 - b. Minierave dhe Guroreve
 - c. Prodhimtaria
 - d. Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar
 - e. Furnizim me ujë; Aktivitetet e Kanalizimeve, Menaxhimit dhe Riparimit të Mbetjeve
 - f. Ndërtimi
 - g. Tregti me shumicë dhe pakicë; Riparimi i Automjeteve dhe Motoçikletave
 - h. Transporti dhe Magazinimi
 - i. Akomodimi dhe Aktivitetet e Shërbimit Ushqimor
 - j. Informacioni dhe Komunikimi
 - k. Veprimtaritë financiare dhe të sigurimit
 - l. Veprimtaritë e Pasurive të Paluajtshme
 - m. Aktivitete Profesionale, Shkencore dhe Teknike
 - n. Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet Mbështetëse
 - o. Administrata Publike dhe Mbrojtja; Sigurimet Shoqërore të Detyrueshme
 - p. Arsimi
 - q. Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe punës sociale
 - r. Arte, Argëtim dhe Rekreacion
 - s. Aktivitete të tjera shërbimi
 - t. Aktivitetet e Familjeve si Punëdhënës; Mallra dhe shërbime të padiferencuara që prodhojnë aktivitete të familjeve për përdorim vetjak
 - u. Veprimtaritë e Organizatave dhe Organeve Ekstraterritoriale

6. Sa punonjës ka firma juaj:

	Mashkull	Femër	Total
a. Në vitin 2023			

7. Statusi ligjor i biznesit:
 - a. Biznes individual
 - b. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (L.L.C)
 - c. Shoqëri aksionare
 - d. Ortakëria e Përgjithshme
 - e. Të tjera

8. A i eksporton firma mallrat apo shërbimet e saj?
 - a. Po (Nëse po, sa është përqindja e shitjeve që eksporton gjatë vitit 2023?) _____
 - b. Jo

Inspektimet

A është inspektuar biznesi juaj në vitin 2023 ?

2023	po
	Jo

1. **Këtu po ju jap listën e të gjitha inspektorateve. Ju lutemi, hidhni një sy.** I INTERVISTUESI: KALOJINI TË PADITURIT LISTËN E INSEKTORATEVE DHE LINI PAK KOHË PËR T'U NJOHUR. PASTAJ PYESNI **Cilat agjenci inspektuan biznesin tuaj në 2023?** PLOTËSONI EMRIN E INSEKTORATEVE NË TABELËN E MËPOSHTME.

#	I. Agjencitë që inspektuan biznesin në vitin 2023	II. # Inspektime 2023	13. Personeli Koha e shpenzuar nga stafi për një inspektim			14. Pagat mesatare (bruto) të stafit të përfshirë?	15. Totali i kostove të tjera për një inspektim (transporti, kontabilistë të jashtëm, etj.)	16. Shuma e gjobave	17. A jeni të kënaqur me punën e inspektorit?	18. A jeni të kënaqur me sjelljen e inspektorit gjatë vizitës inspektuese?
			13.1. Përgatitja	13.2. Inspektimi	13.3. Përcjellja					
1										
2										
3										
4										

2. I INTERVISTUESI: PËR SECILËN AGJENCI QË KA INSPEKTUAR, JU LUTEMI PYESNI **Sa herë është inspektuar biznesi juaj sipas** EMRIT TË AGJENCISË **në vitin 2023?** I INTERVISTUESI: SHËNONI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 12 MË LART.
3. **Tani do t'ju pyes për kohën e stafit të kaluar në një inspektim . Për shembull, nëse një punonjës shpenzoi 2 orë dhe një tjetër 3 orë, kjo do të përbënte 5 orë në mënyrë kumulative, ok? Përveç kësaj, do të doja të bëja dallimin në lidhje me kohën për t'u përgatitur për inspektimin, kohën e kaluar gjatë inspektimit dhe kohën për të ndjekur me inspektorin pas vizitës së inspektimit. Mos harroni se po flasim për kohën e stafit, domethënë kohën e shpenzuar nga të gjithë punonjësit e përfshirë.**
- 3 .1 I INTERVISTUESI: PËR SECILËN AGJENCI QË KA INSPEKTUAR, JU LUTEMI PYESNI **Sa kohë staf kanë shpenzuar të gjithë punonjësit e biznesit tuaj për t'u përgatitur për një inspektim të kryera nga** EMRI I AGJENCISË **në 2023?** JU LUTEMI SHKRUANI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 13.1 MË SIPËR.
- 3.2 I INTERVISTUESI: PËR SECILËN AGJENCI QË INSPEKTOI, JU LUTEMI PYESNI **Sa kohë staf kanë shpenzuar të gjithë punonjësit e biznesit tuaj gjatë inspektimit të kryer nga** EMRI I AGJENCISE ? JU LUTEM, SHKRUANI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 13.2 MË SIPËR.
- 3.3 I INTERVISTUESI: PËR SECILËN AGJENCI QË INSPEKTOI, JU LUTEMI, PYESNI **Sa kohë staf shpenzuan të gjithë punonjësit e biznesit tuaj për të ndjekur** EMRIN E AGJENCISË **pas inspektimit?** JU LUTEM, SHKRUANI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 13.3 MË SIPËR.
4. **Ne dëshirojmë të vlerësojmë kostot e kohës së punës së shpenzuar për inspektime. Keni problem të më tregoni për pagën e përafërt bruto mujore për punonjësit e këtij biznesi, të cilët zakonisht përfshihen në inspektime? Siç e përmenda, përgjigjet tuaja do të mbeten konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllimin e këtij pyetësi.** INTERVISTUESI: JU LUTEMI SHKRUANI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 14 MË SIPËR
5. **Tani do t'ju pyes për kostot e inspektimeve. Kur kujtoni kostot, ju lutemi, mos harroni të përfshini kostot e udhëtimit, nëse po udhëtonit në inspektoriatet, shumën e paguar jozyrtarisht si dhe kosto të tjera. Nuk kam nevojë për një ndarje të detajuar, por një shumë të përgjithshme për një inspektim për secilën agjenci.** I INTERVISTUESI: PËR SECILËN AGJENCI QË INSPEKTOI, JU LUTEMI, PYESNI SE **cilat ishin kostot totale në lidhje me një inspektim sipas** EMRIT TË AGJENCISË **në 2023?** SHKRUANI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 15 MË SIPËR.
6. **Tani, do të doja t'ju pyesja vetëm për gjobat që ka paguar biznesi juaj në 2023?** INTERVISTUESI: JU LUTEMI SHKRUANI SHUMËN NË KOLONËN 16. SIPËR ;
7. 17. **A jeni të kënaqur me punën e inspektorit gjatë vizitës inspektuese?** SHKRUANI PËRGJIGJEN NË KOLONËN 18 SIPER:?
- a. Po
- b. Jo
8. **A jeni njoftuar më parë (para vizitës) për vizitën dhe qëllimin e inspektimit?**
- a. po
- b. Jo

9. Sa përqind e gjobave totale ishin për arsyet e përmendura më poshtë? Totali duhet të shtohet deri në 100%. Nëse I7=0, anashkaloni këtë pyetje.

	Pjesa e gjobave të paguara (në përqindje)
Mungesa e përputhshmërisë	
Kërkesa të paqarta ose jokonsistente ndaj inspektorëve	
Vendime të padrejta nga inspektorët	

10. A mendoni se inspektori ishte i njohur me kërkesat rregullore të nevojshme për inspektimin?
- Po
 - Jo
11. A janë punonjësit e kompanisë plotësisht të ndërgjegjshëm për procedurat e inspektimit dhe detyrimet ligjore dhe teknike të ndërmarrjes suaj?
- Po
 - Jo
12. Cilat janë problemet kryesore në inspektim? – Pyetje me shumë zgjedhje
- Kompetenca e dobët e inspektorit
 - Sjellje e pahijshme
 - Dyfishim dhe mbivendosje të inspektimeve
 - Frekuenca e lartë e vizitave
 - Kërkesa të paqarta rregullatore
 - Kosto e lartë për përmbushjen e kërkesave rregullatore të kontrolluara në inspektime
 - Dënimet nuk përputhen me madhësinë e shkeljes dhe rrezikun
 - Të tjera (specifiko)
13. Gjatë viteve të fundit, a keni vënë re ndryshime pozitive apo negative në procesin e inspektimit?
- Ndryshime pozitive
 - Ndryshimet negative
 - Nuk kam vënë re fare ndryshime